

DOKUMENTET PËR APLIKIM

- a) kërkesë, ku të paraqitet aktiviteti i ushtruar gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës;
- b) ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit (të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, jo më vonë se 1 muaj nga aplikimi);
- c) kontrata e rinovuar, e lidhur para noterit, me vlerësuesin/it e licencuar, për rastet kur kontratave ekzistuese të disponuara u ka përfunduar afati i vlefshmërisë (për rastet kur ka vlerësues të punësuar);
- ç) vetëdeklarim të drejtuesit/ve ligjor/ë, ku ata të deklarojnë se njohin dhe angazhohen të zbatojnë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e profesionit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit. Gjithashtu, të deklarojnë se nuk janë të dënuar nga organet e gjyqësorit, në lidhje me ushtrimin e profesionit të vlerësimit;
- d) vërtetim nga organet tatimore, për shlyerjen nga shoqëria të të gjitha detyrimeve tatimore vërtetim, të lëshuar jo më vonë se 1 muaj nga aplikimi (vërtetim nga drejtoria rajonale tatimore dhe nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore pranë bashkisë respektive).

+ pagesa e tarifës

Dorëzimi, pranimi i aplikimit

- 1. Kërkesa për licencë dhe dokumentet shoqëruese të saj, sipas kësaj rregulloreje, dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.
- 2. Dokumentet për licencë duhet të jenë:
 - a) origjinale ose fotokopje të noterizuara;
 - b) në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar;
 - c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
- 3. Pagesa e tarifës për përfitimin e licencës kryhet ose nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania, ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim, i cili shkarkohet nga portali ose mund të disponohet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë së Zhvillimit Urban.

Kushte paraprake:

- 1. Shoqëria dhe vlerësuesit e shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të plotësojë kushtin që të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore për çështje që kanë lidhje me ushtrimin e aktivitetit profesional si vlerësues dhe të mos jetë në periudhën e ekzekutimit të një mase administrative të mëparshme, kundrejt licencës profesionale për vlerësim.
- 2. Vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të njohë dhe të angazhohet të zbatojë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e këtij profesioni dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit.
- 3. Shoqëria, që kërkon të licencohet, duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore.
- 4. Shoqëria duhet të ketë statusin "aktiv" të ushtrimit të veprimtarisë në QKB dhe të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi.

Afate dhe kufizime

- 1. Licenca për shoqëritë jepet me afat, aq sa afati i kontratës që ka shoqëria me vlerësuesin e kontraktuar (ajo me afatin më të shkurtër, për rastet kur ka më shumë se një vlerësues me kontratë), por jo më shumë se 5 vjet.